



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2023

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga Z. A.E.
Adresa: _____

I nderuar z. E.

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion nr 1010 prot. datë 31.05.2023 (tonën), dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit“, për informacion, lidhur me bazën mbi të cilën janë dhënë informacionet e transmetuara në televizionin ABC Neës për familjarët tuaj, kush i ka marrë këto informacione dhe procedura e ndjekur, përputhshmërinë me ligjin, kushtet dhe kriteret, ju informojmë si më poshtë:

Së pari : nga shqyrtimi i objektit të kërkesës, vërehet se kërkesa juaj për informacion i nënshtrohet dispozitave proceduriale për mënyrën se si të merret informacioni, sipas dispozitave njohëse apo kufizuese të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar“.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, është kërkuar informacion i detajuar nga strukturat përkatëse të cilat e kanë trajtuar rastin. Nga komunikimi shkresor me këto struktura, rezulton informacioni i mëposhtëm :

1. Pranë Autoritetit është depozituar nga Publik TV (përfaqësuar nga N.N.) dhe E.Gj. kërkesa me nr. 643 prot., datë 03.04.2023 për qëllime mediatike, me objekt- Informimi mbi dokumente të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit në lidhje me shtetasin A.Gj. dhe B.Gj., me qëllim realizimin e një studimi në kuadër të figurës historike të shtetasve A.dhe B.Gj..
2. Në bazë të nenit 36, pika ç, 37 dhe 38 të Ligjit nr. 45/2015, dhe Udhëzuesit “Për studiues/media, i miratuar me Vendimin nr. 491, datë 24.09.2020, të Autoritetit, kërkesa u legjitimua.
3. Në datën 03.05.2023, z. E.Gj.- familjar i afërt (kushëri) i A.Gj. dhe B.Gj. ka dhënë miratimin e tij në cilësinë e familjarit (kushëri i vetëm) që media Publik Tv, të kërkojë dhe të marrë për qëllimin e kërkuar dosjen për të dy shtetasit A. dhe B.Gj..
4. Me Vendimin nr 307 datë 08.05.2023, Autoriteti ka vendosur vënien në dispozicion, të kërkuesve, të dokumentacionit dublikatë si më poshtë:
 - a) Fondi 1 hetimor- gjyqësor, dosja 2319, B.Gj., Xh. Gj., Sh. Gj. Etj me 37 faqe dhe
 - b) Fondi 1 hetimor- gjyqësor, dosja 12389 B. Gj. me 118 fletë.
5. Në datën 10.05.2023 Z. N.N. në cilësinë e studiuesit ka nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit pranë institucionit, ku deklarohet se pas marrjes së dokumentacionit

do të ruajë të dhënat personale, merr përsipër të mos përdorë dhe të mos u transmetojë personave të pa autorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale si edhe është i detyruar të vërë në dijeni me shkrim Autoritetin për botimin apo publikimin e dokumenteve të siguruara mbi bazën e ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar.

Së dyti ; ligji nr. 45/2015 i ndryshuar, parashikon në nenin 38 “**Informimi i medias**” të drejtën e përfaqësuesve të medias për të konsultuar të dhënat e Sigurimit ku përcaktohet:

“1. Vënia në dispozicion dhe përdorimi i dokumenteve nga media kryhet në përputhje me nenet 36 dhe 37 të këtij ligji”.

Sa më sipër, nga ana e Autoritetit është ndjekur procedura për shqyrtimin e dokumenteve, vënien në dispozicion dhe përdorimin e dokumenteve nga media, sipas dispozitave të përcaktuara nga ligji, janë garantuar kushtet që qasja me dokumentacionin të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe privatësinë e individëve të përmendur në dosje. nuk kanë respektuar rregullat e konfidencialitetit të të dhënave personale të siguruara sipas këtij ligji.

Së treti : Lidhur me kërkesën tuaj për marrjen e masave administrative për subjektet që kanë shkelur ligjin, ju informojmë se :

Për të gjitha rastet kur konstatohet mosrespektimi i konfidencialitetit të të dhënave dhe përdorimit për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë kërkuar, apo përcjellja tek të tretët në mënyrë të paautorizuar, do të zbatohen parashikimet e nenit 42, pika 1. që parashikon se: “Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë shkeljet e mëposhtme c) mosrespektimi i detyrimeve të marrësit sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 37, të këtij ligji” sipas të cilit: “Dublikatat nuk mund të përdoren nga marrësi për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë kërkuar dhe as të përcillen tek marrës të tjerë”.

Autoriteti do të vlerësojë këtë aspekt dhe do tju informojë në përfundim të procedurës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Në mungesë dhe me Urdhër

Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Financave

Sofi Noti